

“Shumëgjuhësia dhe tregu i punës”

Associazione LEM-Italia

Partner del Portale delle Lingue

d'Europa e del Mediterraneo (LEM)



www.portal-lem.com

Ne bashkëpunim me

Departamentin e Teorive dhe Politikave të Zhvillimit Social, Fakulteti i
Shkencave Politike, Universiteti i Teramo

Universiteti DORIF – Instituti Italian i Kultures Tirane – AFALC Tiranë
Komuna Rosciano – Komuna Lukovë



Manifesto di ©Adriana Civitarese

Teramo Giulianova Fano Adriano (TE) Villa Badessa (PE) Pescara

Tiranë Lukovë Piqeras

Me mbështetjen e (lista në zgjerim)

Keshilli i Europes, Ministero dei Beni e delle Attività Culturali (MiBAC) Italia, Qeveria Shqiptare

Académie Internationale de Droit Linguistique, Montréal

Observatoire Européen du Plurilinguisme

CROMBEL (Comité roman du Comité belge du Bureau Européen pour les Langues moins répandues)

Istituto internazionale del Teatro del Mediterraneo (Sezione italiana)

Fondazione Università di Teramo, Istituto I.S.I.T. Trento

Associazione Villa Badessa, Associazione ALBA (shqiptaret në Abruzzo), AELMA (Arkivi etnoghjesor dhe muzikor në Abruzzo), Associazione Bambun

Një Konferencë ndërkombëtare e përhershme mbi të drejtat gjuhësore

Ekipi italian i projektit franko-italian LEM (Lingue d'Europa e del Mediterraneo), me mbështetjen e Universitetit të Studimeve të Teramo-s dhe partenerëve të shumta institucionale dhe privat, organizon që prej vitit 2007 një konferencë ndërkombëtare të përvitshme, “Ditet e të Drejtave Gjuhësore”.

Një nga qëllimet kryesore të këtij cikli konferencash është të bashkojmë sa më shumë specialiste të prejardhjeve dhe disiplinave të ndryshme rreth temës së të drejtave gjuhësore dhe përçimit gjuhësor: si në funksion të respektimit të të drejtave njerezore, po ashtu dhe në perspektivën e zhvillimit social.

Që nga 2009 këtij manifestimi me karakter shkencor i është bashkangjitur dhe një takim artistiko-letrar, Festivali i letërsive minoritare të Europës dhe Mesdheut.

Viti i gjashtë i të Drejtave Gjuhësore

Migrimet: midis veshitësive gjuhësore dhe trashgimisë kulturore

Konferenca përmblyese e ciklit të konferencave shetëse mbi “Shumegjuhësia dhe tregu i punës”

Call for papers

Edicioni i gjashtë i konferencës ndërkombëtare “Giornate dei Diritti Linguistici” (GDL 2012) do të jetë i fokusuar mbi analizen e fenomenit migrues nga pikepamja e marrëdhënieve socio-gjuhësore dhe kulturore midis grupeve të ndodhur në kontakt – mbi të gjitha, por jo vetëm! Midis Italisë, Shqipërisë dhe Belgjikës frankofone. Në qendër të këtyre marrëdhënieve qëndron, historikisht dhe simbolikisht, Rajoni i Abruzzo-s: këtu vend mikpritjeje, si për shembull për migrimin e shqiptarëve që themeluan Villa Badessa di Rosciano në vitin 1743; këtu vend nisjesh në të shkuarën e afertë e karakterizuar nga fenomene emigruese të dukshme, midis të cilave si vendarritje kryesore, në Europë, është pikërisht Belgjika.

Cilesia e këtyre marrëdhënieve varet nga dialektika e brishtë e rrenjosur në vetë konceptin e integritetit, që është në një masë të mirë e kushtëzuar pikërisht nga çështje të rendit gjuhësor: mangësia, papersosmeria ose pasaktësia në mirëkuptimin e dyanshem (ose dhe me shumë) midis komuniteteve në regjim bashkejetës mund të shpjegohet nga një anë në formë tjetërsimi (humbje të identitetit në favor të modelit mbizotërues) brenda komunitetit të emigruar, dhe nga ana tjetër në formë bashkësisht të veçuar (acarim i detyruar i tipareve identitare si kundërveprim për vetëmbrojtje). Natyrisht, problemi i nderkuptimit nuk është vetëm një problem gjuhësor *stricto sensu*, por me gjerësisht i takon aspekteve kulturore, sociale, simbolike mbi të cilat ndërtohet identiteti subjektiv dhe kolektiv.

Duke u nisur nga këto shqyrtime, një objektiv i parë i GDL 2012 – që përmblyll dhe ciklin e konferencave DORIF, të hapura pikërisht në Teramo në pranverën e vitit 2011, mbi temën e marrëdhënieve midis “Shumegjuhësi dhe tregu i Punës” - <http://www.dorif.it/convegna.php> - kryerja e

nje permbledhje mbi teorite, praktikat dhe mbi profesionalizmin lidhur me fushen e nderkuptimit dhe te dialogut midis kulturave ne marredhenie midis tyre, duke mobilizuar jo vetem gjuhetares por edhe sociologet, juristet, ndermjetesit gjuhesor, aktore institucional etj.

Ne kete prospektive instruktive do te jete e nevojshme te zhvillohet nje analize edhe ne sensin historik e diakronik: migrimet dhe emigrimet e djeshme ne te shumten e rasteve jane kthyer nga situata konfliktuale ne situata prosperiteti, qofte per permiresimin e kushteve materiale te jeteses se individeve dhe te shume komuniteteve, qofte dhe per lindjen e aq te çmuar te shume ishujve gjuhesor. Sot ato, ne fakt, shpesh perfaqesojne jo vetem “keshtjella” te mrekullueshme larmish kulturore, por ndonjehere jane dhe si nje arke thesaresh ne te cilen ruhen trashgimi kulturore, materiale dhe jomateriale, qe ne “memedhe” ose nuk ekzistojne me ose jane demtuar ose ne me te keqen e rasteve jane zhdukur. Nga kjo pikepamje mund te jete e nevojshme – dhe strategjike – te zbulojme format, teknikat dhe teknologjite per te (ri)aktivizuar qarkullimin a komunikimit social, kulturor – por edhe ekonomik e sipermarres – midis vendit amë dhe “ish kolonite”.

Jo «mase e ngurte» (Saussure) por «vend konfliktesh» (Lafont): shoqeria, e me gjeresisht, shoqerite jane gjithmone te pershuara nga fenomene te takimeve gjuhesore e kulturore dhe ne kete takim/perballje subjekti dhe vete shoqeria mund te perfitojne mundesi te ndryshme rritjeje. Por mbi te gjitha na duhet te hetojme me themel se kush jane rruget e duhura dhe kush eshte menyra e duhur per ti shkelur ato.

Fusha kerkimore dhe makrotema

Mbi bazen e ketyre mbikqyrjeve, propozimet per komunikime ne GDL 2012 duhet te vertiten ne nje prej kater makrotemave qe pasojne, secila e koordinuar nga nje Komitet Shkencor specifik. Si me poshte parashtrojme keto tematika, te artikuluar ne nje seri temash me specifike si dhe Komitetet Shkencore perkatese – perberja e te cileve eshte ende per tu persosur:

1. Te drejtat gjuhesore te migruesve: problemi i minoriteteve te reja, diaspora te vjetra e te reja.

- Minoretetet e ngulimeve te reja: Cilat te drejta gjuhesore?
- Emigrantet e brezit te dyte dhe shtetesia, midis “ius soli” dhe “ius sanguis”.
- Gjuha ne diaspore: percaktues apo relik identiteti?
- Te drejtat gjuhesore jane per emigrantet si e drejta per shendetin.
- Gjuha dhe gjuhet e emigrimit, midis *sabir* dhe gjuhes frenge.

Komiteti Shkencor (lista provizore)

Vittorio Dell’Aquila, Fernand de Varennes, Henri Giordan, Alexey Kozhemyakov, Gaetano Rando, Gianluca Sadun Bordoni, Joseph G. Turi

2. Kerkime dhe profesionalizem per integrimin gjuhesor e kulturor.

- nderkuptimi midis gjuheve te peraferta: gjendja e tanishme dhe prospektivat.
- Perkthyes dhe ndermjetesues gjuhesor per integrimin.

- Sfida te reja ne fushen e edukimit gjuhesor.
- Dygjuhesia, tjetersimi, konflikti shoqeror: situatat kritike dhe zgjidhjet e mundshme.
- Shumegjuhesia dhe tregu i punes: mbeshtetja e emigranteve te rinj ne nderkombetarizimin e bizneseve.
- Analiza e diskutimit dhe dialogut nderkulturor: Analisi del discorso e dialogo interculturale: perfaqesime, stereotipe, pasqyrime, çensurime, imazhi qe kemi per gjuhet.

Komiteti Shkencor (lista provizore)

Michele De Gioia, Tullio De Mauro, Paola Desideri, Enrica Galazzi, Marie-Christine Jullion, Danielle Lévy, Danielle Londei, Cristina Schiavone, Christian Tremblay

3. Abruzzo: vend mberritjeje, vend nisjesh, vend kalimi.

- Emigrimi abrucez: tiparet antropologjike, gjuhesore, kulturore, gjenetike.
- Komunitetet e abrucezeve jasht Italise. Karakteristika dhe perberja.
- Abruzzo si pikesynim: prurjet orientale per identitetin rajonal.
- Mbetjet historiko-gjuhesore: huazimet ne dialektet abruceze.
- Te tej kalosh territorin: qe prej shtegtimimit te bagetive ne turizmin e ngadalte.

Komiteti Shkencor (lista provizore)

Leandro Di Donato, Rossella Di Federico, Domenico Di Virgilio, Jean-Luc Fauconnier, Adriana Gandolfi, Everardo Minardi, Vito Moretti, Oriano Notarandrea, Silvio Pascetta, Ezio Sciarra, Gianfranco Spitilli, Liborio Stuppia

4. Arbëreshët dhe ura historiko-kulturore midis Italise dhe Shqiperise (Villa Badessa-Piqtaras)

- Midis Italise dhe Shqiperise: Arberia, ose identitei i shumefishte.
- Kolonia e imagjinuar: te verteta historike dhe legjenda mbi origjinen e Villa Badessa.
- Memedheu i harruar: vetedija e origjines ne komunitetin badesan, dje dhe sot.
- Lidhja e keputur. Te rindertojme uren Itali-Shqiperi.
- Emigrimi si shpetim i trashgimise kulturore: trashgimia artistike dhe fetare te Villa Badessa.

Komiteti Shkencor (lista provizore)

Francesco Altimari, Pierfranco Bruni, Marcel Courthiade, Robert Elsie, Minella Gjoni, Donato Michele Mazzeo, Annarita Miglietta, Carlo Pellicano, Alberto Sobrero, Tullio Telmon, Fulvia Veneziani

Gjuhet e punimeve

Italisht, frengjisht, shqip, anglisht. Gjuhë te tjera jnae te pranuar per publikimin e akteve.

Afatet

10 shkurt 2012

Leshimi i qarkores se pare "Call for papers" ne versionin shumegjuhesh dhe venia ne dispozicion te sitit zyrtar te "Seste Giornate dei Diritti Linguistici" ne sitin LEM-Italia (www.associazionelemitalia.org)

10 maj 2012

Afati i fundit per dergimin e nje propozimi kominkues ose te posterave, ne gjuhete e punimeve te Konferences (2 faqe nga bibliografia e referuar), bashkangjitur nga CV shkencor (max 2 faqe).

Inviare le proposte e i relativi allegati **ad entrambi** i seguenti indirizzi di posta elettronica:

gdl2012@associazionelemitalia.org

giagresti@yahoo.it

20 qershor 2012

Pergjigje e Komitetit shkencor te GDL 2012(qofte ne rast aprovimi po ashtu dhe ne rast mos aprovimi te propozimit per komunikim ose te posterit) e njekohesisht dergimin e normave redaksore per publikime te mundshme. Fleta e proves eshte e shkarkueshme ne faqen <http://www.associazionelemitalia.org/le-nostre-azioni/collana-di-studi-lem.html>

30 shtator 2012

Publikimi i programit provino

20 tetor 2012

Pubblicazione del programma definitivo

6-12 nentor Konferenca

31 dhjetor 2012

Afati i fundit per dergimin e materialeve per publikim.

10 shkurt 2013

Pergjigje e Komitetit per rileximin dhe lajmerimin e autoreve reth pranimit ose jo te kontributit te tyre per publikimin e volumeve te akteve, njekohesisht me dergimin e drafteve.

Pranvere 2013

Publikimi i akteve ne volume ne [Collana Lingue d'Europa e del Mediterraneo](http://store.aracneeditrice.com/it/collana.php?collana_sigla=LEM&sortby=isbn_ricerca) - http://store.aracneeditrice.com/it/collana.php?collana_sigla=LEM&sortby=isbn_ricerca

Regjistrimi

Per te gjitheti (studente dhe kushdo qe deshiron) hryja ne punimet e konferences eshte absolutisht e lire.

Per sa i perket relatoreve, e per cilindo qe deshiron te ndjeke me nga afer punimet e konferences (te marre ne pritje, transferime etj) eshte parashikuar nje kuote e vogel regjistrimi:

Kuota e regjistrimit per **pjesemarresit relator** eshte 100 euro, e reduktuar ne 70 per pjestaret e DORIF dhe te shoqates LEM-Italia. Regjistrimi ju jep te drejten e sherbimit te autobuzit per pjesen italiane te konferences, ne volumet e akteve GDL 2010 (ose, me zgjedhje, volumit te akteve te GDL 2011), pritjes me pije ne ditet e konferences ne Itali (darka shoqerore e pa perfshire) dhe kontributit

te punimit pe redaktimin e akteve GDL 2012. Per **pjesmarresit jo relator** kuota e regjistrimit eshte 50 euro e shkurtuar ne 30 per anetaret e DORIF dhe te shoqates LEM-Italia.

Pjesemarsit mund te paguajne kuoten e regjistrimit (brenda 15 shtatorit 2012) direkt nga faqja:

<http://www.associazionelemitalia.org/iscrizione-online-gdl-2012>

Fale sistemit te garantuar e te sigurte PayPal, duke zgjedhur ne menune forme gjuhe llojin e regjistrimit duke specifikuar, si ne shembull: MBIEMER + EMER + “REGJISTRIM GDL 2012”

Ose ne alternative, pjesmarresit mund te paguajne kuoten e regjistrimit (brenda 15 shtatorit 2012) nepermjet nje transaksioni bankar (me shpenzime ne ngarkim te kujt ben transaksionin) per llogari te:

Associazione LEM-Italia
Banca dell'Adriatico, Filiale di Teramo Corso S. Giorgio (4101)
IBAN: IT80I0574815300100000101370
Causale: “Iscrizione GDL2012” + EMER e MBIEMER

Pubblikimi i Akteve

Aktet do te publikohen ne leter brenda vitit 2013 ne Koleksionin “Lingue d’Europa e del Mediterraneo” (nenkoleksion “Diritti Linguistici”, drejtuar nga Fernand de Varennes) dhe ne versionin multimedial ne sitin e Associazione LEM-Italia, www.associazionelemitalia.org, qe do te mikprese edhe nje seksion per download per te ngarkuar pdf-te e volumeve te Koleksionit LEM.

Sekreteria dhe Redaksia

Lucilla Agostini, Giovanna Manilla, Silvia Pallini
gdl2012@associazionelemitalia.org

Draft Programi i GDL 2012

Data	Mengjes	Mbasdite	Salloni i larmise gjuhesore.
E Marte 6 Nentor Università di Teramo + Università di Teramo	09:30-10:30 Regjistrimi i pjesmarresve 10:30 Pershendetjet e Autoriteteve dhe hapja e Punimeve. 11:00 Konference plenare Tema 2 punime Pushim	14:30 – 18:00 Perurimi i 2° i “Salloni i larmise gjuhesore” 15:00 – 18:00 Sesioni/et monotematik/e komunikues i Tema 1 Te drejttat gjuhesore te emigranteve: problemi i minoriteteve te reja, diasporat e vjetra dhe te reja. 18:00 Kthim ne Giulianova ne Hotel Europa Darka e lire	Mengjes dhe mbasdite
	Ore 12:00 Konference plenare Tema 1 Ore 13:00 Pushimi i drekes		
E Merktire 7 Nentor UniTE + Fano Adriano (TE)	09:30-10:30 Regjistrimi i pjesmarresve 10:30 Konference plenare Tema 3 Pushim 12:15 Udhetim ne Fano Adriano 13:00 Pushimi i drekes	14:30 – 17:30 Sesioni plenar monotematik komunikues i Tema 3 Abruzzo: vend mberritjeje, vend nisjesh, vend kalimesh. 17:30 – 19:00 Vizite ne Fano Adriano 19:00 Kthim ne Giulianova, Hotel Europa 21:00 Darka shoqerore	Mengjes dhe mbasdite

<p>E Enjte 9 Nentor Hotel Europa ne Giulianova + Villa Badessa + Pescara</p>	<p>09:00-10:00 Regjistrimi i pjesmarresve</p> <p>10:00-12:30 Sesioni/et monotematik/e komunikues i Tema 2</p> <p>Kerkime dhe profesionalizem per integrimin gjuhesor dhe kulturor</p> <p>13:00 Dreke Hotel Europa</p>	<p>15:30 Ekskursion ne Villa Badessa (PE) Homazhe per Lino Bellizzi Presantimi i volumit LATIFI Lumturi, MANILLA Giovanna & PALLINI Silvia. «Kujtimi i Piqeras. Tregime mbi emigrimin shqiptar ne Villa BadessaNarrazioni». Roma: Aracne («Lingue d'Europa e del Mediterraneo»), 2012</p> <p>19:00 Pescara Vecchia: Caffè letterario / Auditorium Petruzzi</p> <p>Cerimonia e dhenies se çmimit "Laura Agarossi – Retaggio e innovazione" Me pritje Kthimi ne Hotel Europa ne Giulianova</p>	
<p>E Premte 9 Nentor</p>	<p>Udhetim Pescara-Tirana</p>	<p>Konferenca dhe kominkime ne Tirane per Temen 4 Arbëreshët dhe ura historike kulturore Itali-Shqiperi (Villa Badessa-Piqeras) Darka te gjithë sebashku Fjetja ne hotel ne Tirana</p>	
<p>E Shtunes 10 Nentor</p>	<p>Udhetim drejt jugut</p>	<p>Mberritja mbasdite. Takim ne Lukovë me autoritetet. Prezantim i LATIFI Lumturi, MANILLA Giovanna & PALLINI Silvia. «Kujtesa e Piqerasit. Tregime mbi emigrimin shqiptar ne Villa Badess». Roma: Aracne («Lingue d'Europa e del Mediterraneo»), 2012.</p> <p>Ne mbremje: projektim me titra ne shqip i filmit: <i>Arte del Viaggio Arte dell'Incontro</i> (©LogicFilm et Associazione LEM-Italia 2012)</p> <p>Darka ne restorantet e shperndare ne Lukovë</p>	
<p>E Djele 11 Nentor</p>	<p>Ekskursion ne Piqeras. Dreka ne restorantin e shperndare dhe kthim ne Tirane ne mbremje</p>	<p>Kthim ne Tirane. Darka e lire.</p>	
<p>E Hene 12 Nentor</p>	<p>Rientro a Pescara</p>		

Organizoni qendrimin tuaj

Per vitin e trete rradhazi, me rastin e Diteve te Drejtave Gjuhesore, kemi firmosur nje marreveshje te posaçme, ekskluzive dhe shume te leverdisshme me Hotel Europa ne Giulianova (TE). Behet fjale per nje Hotel me tre yje i zinxhirit te hotelerive prestigjioze Best Western. I ndodhur vetem pak hapa nga nje prej plazheve me te mrekullueshme te Adriatikut, e me nje restorant te shkelqyer, jemi te bindur qe mund te perfaqesoje nje kornize ideale per te bere te mundur qe GDL 2012 te jete nje rast edhe per tu shplodhur e natyrisht te krijoje nje moment shkembimesh midis konferenciereve.

Te gjithë pjesëmarrësit në GDL 2012 janë të ftuar të zgjedhin Hotel Europa për të qëndruar në Abruzzo gjatë zhvillimit të pjesës së parë të Konferencës. Një autobus i posaçëm do të jetë në shërbim për rrugën nga Hoteli dhe shumë vende të tjera që do të vizitohen në lidhje me konferencën (Universiteti i Teramo etj) do të jetë në dispozicion të të gjithëve.

Te gjithë pjesëmarrësit rregullisht të regjistruar në GDL2012 mund të gezojnë nga tarifë speciale të vena në dispozicion nga Hotel Europa si më poshtë:

- Çmimi ditor për një dhomë dopie për përdorim vetjak, përfshirë mëngjesin: € 52,00
- Çmimi ditor për një dhomë dopie për dy persona, përfshirë mëngjesin: € 76,00
- Plotësim i mundshëm për opsionin gjysëm pension, përfshirë pijet, në ditë për person: € 18,00

Për prenotimin e dhomës suaj mund të mbështeteni në profesionalizmin shumëgjyesh të personelit të Hotel Europa nëpërmjet kontakteve si më poshtë:

www.htleuropa.it

info@htleuropa.it

tel. +39 085 8003600

fax +39 085 8000091

Në rast se do të hasnit probleme, Sekretaria e GDL 2012 do të jetë në dispozicionin tuaj për t'ju ndihmuar në prenotimin e dhomës suaj.